

VENDIM
Nr. 132, datë 7.4.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK PËR TRANSFERIMIN
(NËPËRMJET VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE) E ASETEVE FIKSE TË
CENTRALIT FOTOVOLTAIK BLUE 1 NË FAVOR TË GREEN FOR GROWTH FUND
SOUTHEST EUROPE S.A., SICAV-SIF**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, germa “b”, neneve 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1135/1 prot., datë 6.4.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) e aseteve fikse të centralit fotovoltaik ‘Blue 1’ në favor të ‘Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., Sicav-Sif’”,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1135 prot., datë 27.3.2023 prot., shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të centralit fotovoltaik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., Sicav-Sif”, me qëllim garantimin e shlyerjes së kredisë.

- Shoqëria është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, dhe është mbajtëse e licencës nr. 507, seria P22.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në zbatim të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin për pikën 1, gerrat “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g”, “i”, “j” dhe pikën 3. Shoqëria duhet të plotësojë dhe dokumentacionin në vijim:

Neni 7, “Përmbajtja e kërkesës për transferim”.

Pika 1. Një përshkrim i të licencuarit që përmban informacion mbi:

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë informacion mbi efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve.

- germa “h”: Shoqëria duhet të sqarojë/saktësojë emërtimin e llojit të aseteve të përcaktuar në aneksin 1 të Marrëveshjes së barrës siguruese, si dhe të risjellë aneksin 1 të marrëveshjes së barrës siguruese, së bashku me vlerat konkrete të secilit aset.

- Pika 6: Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse dëshiron që pjesë të dokumentacionit të depozituar nga ana e saj në kuadër të këtij aplikimi të mos jenë të hapur për publikim së bashku me arsyet përkatëse.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) e aseteve fikse të centralit fotovoltaiik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A, Sicav-Sif”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti